

*Në Itali, shëndeti është
një e drejtë e garantuar
për të gjithë.*

E DREJTA E SHËNDETIT PËR EMIGRANTËT



Nëse nuk ndihesh mirë, nëse ke nevojë për një mjek, edhe nëse je pa dokumente, mund të marrësh kura mjekësore. Askush nuk do të të denoncojë në polici. Do të të duhet vetëm kodi STP (I huaj me prani të përkohshme) që do të të jepet nga ASL-ja (Agjencia Lokale e Shëndetit) ose nga spitalet. Me kodin STP ke të drejtën të marrësh kura urgjente dhe thelbësore Nga Shërbimi Shëndetësor Rajonal. Mund ta kërkosësh edhe pranë ASL-së më të afërt.

ASISTENCË MJEKËSORE E NIVELIT TË PARË

Nëse e ke tashmë një leje qëndrimi, duhet të regjistrohesh pranë Shërbimit Shëndetësor Kombëtar duke shkuar pranë ASL-së së komunës ku banon (specifikohet te leja e qëndrimi). Merr me vete lejen e qëndrimit (ose vërtetimin e kërkesës për lëshim dhe rinovim) dhe kodin tënd fiskal (provizor ose përfundimtar).

Kur të regjistrohesh pranë Shërbimit Shëndetësor, zgjidh mjekun tënd të përgjithshëm dhe/ose pediatrin për fëmijët e tu. Ata ofrojnë falas: vizita mjekësore, receta mjekësore ilaçesh, receta për vizita të specializuara dhe analiza, kërkesa për shtrim në spital, certifikata për shkollën dhe për punën.

Do të të dorëzohet karta e shëndetit. Mos harro ta marrësh gjithmonë me vete kur shkon te mjeku, në farmaci ose në spital.

Nëse ndihesh keq gjatë natës, ose gjatë ditëve të festave, është i disponueshëm shërbimi i ndihmës së vazhdueshme: mund t'i telefonosh ose të shkosh direkt në ambulancën më të afërt.

ANALIZAT DHE VIZITAT E SPECIALIZUARA

Për analizat dhe vizitat e specializuara mund të kërkohet të paguani një kuotë, "biletë", që shërben për të përballuar shpenzimet shëndetësore. Disa persona, për shembull, të sëmurët kronikë (me diabet, hipertension, sëmundje kardiovaskulare, tumore) nuk e paguajnë biletën.

Mënyra e prenotimit

Analizat dhe vizitat e specializuara të kërkuara nga mjeku yt bazë dhe/ose pediatri, mund t'i prenotosh në mënyrat e mëposhtme:

- Pranë sporteleve CUP ASL Bari;
- Duke telefonuar në numrin e gjelbër 800 345477 aktiv nga e hëna në të premte nga ora 8:00 deri në 18:30 dhe të shtunën nga ora 8:00 deri në 13:00;
- Përmes shërbimeve online të faqes së internetit të ASL-së;

- Me **aplikacionin Puglia Salute**, ose nga faqja e internetit <https://www.sanita.puglia.it/servizi-online>
- Përmes emailit në adresën servizio.cup@asl.bari.it duke dërguar vetëm kodin fiskal të personit të asistuar dhe Numrin e Recetës Elektronike (NRE). Në email duhet të specifikoni edhe një numër telefoni dhe situata të mundshme klinike të veçanta. Theksojmë se kërkesat që vijnë në adresën e specifikuar duhet të menaxhohen ekskluzivisht pranë strukturave të afërta me ASL BARI;
- Pranë farmacive të certifikuara (shërbim ka një kosto prej 2 eurosh).

Nëse nuk mund të paraqitesh në takim

Mund të anulosh të paktën 48 orë përpara (përveç së dielës dhe ditëve të festave).

Do të të komunikojmë një numër që duhet të ruhet për të paktën gjashtë muaj, për të mos pasur sanksionet e parashikuara (DGR 2268/2010).

Vënia në dispozicion e vendit për të tjerët është një akt përgjegjësie civile.

Mund ta anuloni takimin:

- Duke telefonuar në numrin 080 5842998, aktiv çdo ditë për 24 orë;
- Përmes shërbimeve online të faqes së internetit të ASL-së;
- Me aplikacionin Puglia Salute, ose nga faqja e internetit <https://www.sanita.puglia.it/servizi-online>
- Pranë sporteleve CUP ASL Bari;
- Pranë farmacive të certifikuara (shërbim ka një kosto prej 2 eurosh).

FARMACITË DHE ILAÇET

Ilaçet jepen me recetë nga mjeku dhe mund t'i blesh në farmaci. Në çdo zonë ndodhet gjithmonë një farmaci e hapur edhe gjatë natës dhe gjatë ditëve të festave: çdo farmaci afishon në pjesën e saj të jashtme se cilat farmaci të turnit operojnë në zonë. Disa ilaçe janë falas, të tjerë me biletë ose me pagesë. Ka edhe të tjerë që paguhen plotësisht.

ÇFARË TË BËSH NË RAST EMERGJENCE

Në rast emergjence ose rreziku për jetën, telefono në numrin 112. Duhet t'i komunikosh operatorit emrin dhe mbiemrin, arsyen e telefonatës dhe adresën ku do duhet të vijë ambulanca të të marrë. Përndryshe, mund të shkosh drejt e në Urgjencën e spitalit më të afërt. Do të të caktohet një kod me ngjyrë (i bardhë, i gjelbër, i verdhë ose i kuq) në bazë të gravitetit të situatës. Nuk nevojitet leja e qëndrimit për të shkuar në urgjencë.

SHËNDETI I GRAVE DHE FËMIJËVE

Nëse je shtatzënë, në Itali ke të drejtën e asistencës mjekësore. Përveç kësaj, ke të drejtat e mëposhtme:

Metodat kontraceptive - Në Itali pilulat kontraceptive janë të ligjshme dhe mund të jepet recetë falas për to nga gjinekologët pranë "konsultoreve". Blihen në farmaci.

Ndërprerje shtatzënie - Në Itali, një grua mund të zgjedhë ta ndërpresë shtatzëninë brenda 90 ditësh nga menstruacionet e fundit. Në rast rreziqesh të mëdha për shëndetin e gruas ose të fëmijës, procedura mund të bëhet me certifikatë mjekësore edhe deri në 150 ditë nga menstruacionet e fundit. Ndërprerja e shtatzënisë bëhet falas dhe mund të kryhet vetëm në një spital publik.

Lindje anonime - Në Itali, nëse një grua nuk mund të kujdeset për fëmijën e saj, mund të kërkojë gjithsesi asistencë mjekësore gjatë lindjes dhe të vendosni të mos e njihni fëmijën.

Drejtoju **konsultores** në zonën tënde. Është falas dhe nuk shërben receta mjekësore. Shëndeti i fëmijës suaj është i rëndësishëm dhe **vaksinat** janë mënyra më efikase për të parandaluar sëmundje infektive dhe komplikimet e tyre. Në Itali, disa vaksina janë të detyrueshme (kundër difteritit, tetanozit, poliomelitit, Hepatitit B), të tjera janë të rekomanduara. Fol me pediatrin për të marrë informacione dhe orientime. Vaksinimet bëhen nga ASL-ja përkatëse dhe fëmijët e tu kanë të drejtë edhe nëse nuk ke një leje qëndrimi.

DHUNA MBI GRATË

Dhuna kundër grave është një shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave. Përfshin gjithë veprimet që mund të shkaktojnë një dëm të llojit fizik, seksual, psikologjik dhe ekonomik. Ke pësuar dhunë ose:

- Të kanë kërcënuar, sharë ose goditur
- Të kanë përndjekur ose ndjekur ose kontrolluar vazhdimisht
- Të kanë përdhunuar ose detyruar të prostituosh
- Të kanë ngacmuar në vendin e punës
- Të kanë detyruar të abortosh ose të braktisë fëmijën tënd.
- Të kanë detyruar të lypësh në rrugë ose të punosh pa pagesë
- Të kanë sjellë në Itali me mashtrim ose me forcë
- Të kanë detyruar të pësosh gjymtime gjenitale ti ose vajza jote.

Nëse ke pësuar dhunë, kontakto NUMRIN KOMBËTAR KUNDËR DHUNËS 1522 ose një nga Qendrat kundër Dhunës të territorit tënd.

Mund të gjesh seli të ndryshme të qendrave kundër dhunës në lidhjet e mëposhtme:

[LINK](#)

- Nëse ndodhesh në Itali, mund të kërkojsh një leje qëndrimi:
- Nëse je përndjekur ose rrezikon të përndiqesh dhe/ose ke pësuar dhunë të rëndë në vendin tënd të origjinës (mbrojtje ndërkombëtare);
- Nëse ke pësuar çdo lloj dhune, abuzimi, shfrytëzimi për punë, prostitucion të detyruar ose krime në kontekstin shtëpiak (mbrojtje humanitare) ose duke u drejtuar pranë Qendrave kundër Dhunës ose Forcave të Policisë, ke të drejtën për një Leje Qëndrimi sipas nenit 18 Bis të Dek.legjis 286/98 ;
- Nëse duhet të mbrosh të drejtat e tua përpara Gjykatës, nëse je akuzuar ose je viktimë e një krimi (leja e qëndrimit për arsye drejtësie)

SHËNDETI MENDOR

Mund të ndodhë që të ndihesh shumë i trishtuar, i hutuar ose pa fuqi. U ndodh shumë njerëzve, veçanërisht nëse jetojnë larg shtëpisë ose në një vend të ri. Nëse ndihesh kështu, ki parasysh që nuk je vetëm. Mund t'i drejtohesh shërbimeve falas të Departamentit të Shëndetit Mendor të ASL-së së komunës ku banon (Qendra e Shëndetit Mentor, Shërbimi Psikiatrik i Diagnostikimit dhe Kurës, Konsultorja ose Sporteli i Këshillimit Psikologjik për Emigrantët).

Lexo [Udhëzuesin e shërbimeve](#) të ASL-së në Bari

Kontakte të dobishme në qytetin e Barit që mund të kontaktosh për të kërkuar ndihmë dhe më shumë informacion.

- Zyra e emigracionit të ASL-së në Bari: Via Caduti di Via Fani, 25
 - PIS (Ndihma e Shpejtë Sociale): telefoni në numrin e gjelbër falas 800 093 470, aktiv 24 orë, për të gjitha ditët e vitit.
 - Sporteli i emigracionit - Sekretaria Sociale: mund t'i gresh të gjitha selitë në faqen e internetit të Komunës së Barit
<https://www.comune.bari.it/web/egov/-/servizio-di-segretariato-sociale>
 - Sporteli Ligjor dhe Socio-Shëndetësor "Casa delle Culture": Via Barisano da Trani, 15
- 080 6933798 - sportellolavorocasadelleculture@reteoltre.it
- Qendrat e asistencës sociale dhe shoqatat që ofrojnë mbështetje për emigrantët

Për më shumë informacion, mund të lexosh Udhëzuesin e shërbimeve të ASL-së në Bari, duke klikuar mbi këtë lidhje.

[LINK](#)

MOS HARRO!

Shëndeti është një e drejtë e të gjithëve. Mos hezito të kërkosht ndihmë, nëse të nevojitet. Strukturat shëndetësore janë aty për të të ndihmuar, edhe nëse nuk ke dokumente të rregullta.

SIGURIA NË SHTËPI

Banesa është një vend ku kalohet pjesa më e madhe e kohës dhe ku ndihesh i sigurt. Është e rëndësishme që të jetë vërtet një vend i sigurt si për të rriturit, por mbi të gjitha për fëmijët! Ja gjërat për të cilat duhet të bësh kujdes:

- Elektriciteti dhe prizat e korrentit: mos i lër pajisjet pa mbikëqyrje dhe bëj kujdes që fëmijët të mos fusin objekte në prizat e korrentit ose të luajnë me kabllot elektrike. Mos e përdor asnjëherë tharësen e flokëve pranë ujit ose me duart e lagura dhe këmbët zbathur.
- Siguria në ambiente: bëj kujdes celularët ose objektet me majë që mund të shkaktojnë plagë. Kujdes edhe ndaj rënies, mbi të gjitha te fëmijët shumë të vegjël. Ngrohja: nëse përdoren ngrohëse me flakë (me vajguri, gaz ose dru), ndërrojeni ajrin shpesh. Mos përdor asnjëherë dru ose qymyr në dhomat e gjumit sepse ka rrezik vdekjeje. Mbajini ngrohëset gjithmonë larg objekteve (lodrave, veshjeve, tendave) që mund të marrin flakë. Gatimi: mos i lër tenxheret e nxehta pranë fëmijëve. Gatimi në dhomë është i rrezikshëm edhe nëse përdoren furnela elektrike!
- Ushqimet: në ushqimet e ambalazuara, kontrollo gjithmonë datën e skadimit. Bëj kujdes nëse blen ose merr produkte të paambalazuara, sepse mund të kenë skaduar ose të përmbajnë substanca toksike!
- Detergjente dhe ilaçe: mos lër detergjente, ilaçe mizash, dezinfektues ose ilaçe pranë fëmijëve. Mos e ndërro enën. Enët origjinale kanë etiketë dhe mbyllje sigurie dhe janë menduar për të shmangur gëlltitjen e substancave aksidentalisht.